



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
GRUPI I MONITORIMIT

Nr. 2019 prot.

Tiranë, më 12.04.2021

URDHËR

Nr. 85, datë 12.04.2021

"PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBIKËQYRJEN E SJELLJES NGA  
GRUPI I MONITORIMIT PËR NËPUNËSIT CIVIL NË ZYRËN E  
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË GJATË PERIUdhËS SË  
FUSHATËS ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET NË KUVENDIN E  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PRILL 2021"

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës "c", të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive enteve publike, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e sjelljes nga grupi i monitorimit për nëpunësit civil në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Prill 2021, sipas tekstit bashkëlidhur dhe aneksit nr. 1 pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



## RREGULLORE

### “PËR MBIKËQYRJEN E SJELLJES NGA GRUPI I MONITORIMIT PËR NËPUNËSIT CIVIL NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË GJATË PERIUdhËS SË FUSHATËS ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PRILL 2021”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës “c”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", vendimit nr. 9, datë 26.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive enteve publike, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", si dhe në zbatim të urdhrin nr. 84, datë 12.04. 2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë fushatës zgjedhore”:

- ✓ me qëllim që të vendoset kontrolli mbi sjelljen e nëpunësve civilë në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike në kushtet e Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë,
- ✓ për të siguruar parimin e meritës dhe paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i shërbimit civil (*neni 5, Kreu II, i ligjit në fjalë*);
- ✓ për të siguruar zbatimin e ligjit, në drejtim të respektimit të të drejtave politike të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohet pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike;
- ✓ si dhe për të siguruar vijueshmërinë normale dhe të pa ndikuar nga fushata zgjedhore, te veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

Grupi i Monitorimit, harton këtë Rregullore të Brendshme e cila përcakton objektin e veprimtarisë së tij, si dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga nëpunësit civilë, gjatë periudhës së fushatës elektorale, të cilat dotë jenë edhe objekt i kontrollit të grupit *ad-hoc*, të ngritur në këtë rast.

Objekti i veprimtarisë së këtij grupi është monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

Numri minimal për ngritjen e Grupit të Monitorimit është me 3 (tre) nëpunës civil. Grupi ka përbërje në mënyrë të detyrueshme drejtuesin e njësisë së administrimit të burimeve

njerëzore, i cili kryeson Grupin e Monitorimit, gjithashtu dhe dy anëtarë të tjerë, njëri prej të cilëve caktohet si koordinator, me qëllim mbajtjen kontakteve me palët e interesuara dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Grupi i Monitorimit vepron në bashkëpunim të ngushtë me eprorët direkt të nëpunësve civilë, si dhe me njësinë e administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të respektojë diskrecionin ligjor të këtyre subjekteve, në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj.

Puna për realizimin me sukses të objektivit të këtij Grupi do të përqendrohet në këto aspekte të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

1. Në një regjistër të posaçëm, i cili administrohet nga Grupi i Monitorimit, nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duhet të shënojnë çdo ditë hyrje - dalje në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08:00 -16:30 (nga e hëna deri në të enjte), ndërsa për ditën e premte nga ora 08:00-14:00.

2. Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, shënon në orën 08:00, të gjithë nëpunësit civilë që janë prezent referuar grafikut të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet të cilit është organizuar nëpërmjet telepunës (për shkak të pandemisë Covid-19), destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.

3. Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listë prezenca e nëpunësve civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dotë nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që dotë materializojë veprimtarinë e tij.

4. Nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e telefonit, pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

5. Eprorët direkt, duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së nëpunësve të tyre, në të kundërt, mos pasja dijeni për mungesa të nëpunësve civilë, do të konsiderohet si mos përmbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.

6. Gjatë orarit zyrtar 08:00 deri 16:30 (nga e hëna në të enjte) si dhe 08:00 deri 14:00 (ditën e premte), nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.

7. Nëpunësi civil i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me kolegët apo qytetarët, të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e postareve, fletëpalosjeve dhe të simboleve të

subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

8. Nëpunësi civil i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të informojë Grupin e Monitorimit, në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

9. Pas orarit zyrtar, nëpunësi civil i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.

10. Grupi i Monitorimit dotë organizojë kontrolle në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit prezent në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.

11. Grupi i Monitorimit, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga ky grup, komunikon çdo ditë me personin e kontaktit, pjesë e Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe përcjell në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet samë objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.

12. Grupi i Monitorimit ndjek me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kundërshtim me ligjin.

13. Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit i dërgon për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë eprorit direkt, ose pranë Komisionit të Disiplinës, sipas rëndësisë së shkeljes së kryer.

14. Dispozitat e kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga Grupi i Monitorimit si dhe nga nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilët duhet të njihen me këtë rregullore, nëpërmjet Drejtorisë së Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, me qëllim që të mundësohet zbatimi i rregullave të vendosura në të, nga ana e tyre.

15. Veprimi në kundërshtim me këtë rregullore, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civil të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

## GRUPI I MONITORIMIT

**Znj. Vilma Kola** Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar;

**Znj. Alma Zili** Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, Anëtar (Koordinator);

**Znj. Egrama Tafaj** Specialist në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore, Anëtar.

Aneks nr. 1 : Modeli i aktit të konstatimit

Aneks nr. 1. Modeli i aktit të konstatimit						
INSTITUCIONI: ZYRA E INSEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË						
AKT KONSTATIMI						
<p>Në lidhje me prezencën e nëpunësve civilë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në datën ____/____/2021, në kuadër të monitorimit të sjelljes së tyre, gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme, sipas tabelës në vijim:</p>						
(1) Nr.	(2) Nëpunësi civil (Emër/Mbiemër)	(3) Emërtesa e pozicionit të punës	(4) Prezenca në punë në orën 8:00 (Nëpunësit prezentë nënshkruajnë individualisht/Për nëpunësin që mungon shëno arsyen)	(5) Kontrolli i Grupit të Monitorimit Ora (Nëpunësit prezentë nënshkruajnë individualisht/Për nëpunësin që mungon shëno arsyen)	(6) Kontrolli i Grupit të Monitorimit Ora ____ (Nëpunësit prezentë nënshkruajnë individualisht/Për nëpunësin që mungon shëno arsyen)	(7) Përfundimi i orarit zyrtar të punës 16:30 (nga e hëna deri të enjten), 14:00 (të premten) (Nëpunësit prezentë nënshkruajnë individualisht/Për nëpunësin që mungon shëno arsyen)
1						
2						
3						
4						